




REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

REKTORATI

DREJTORIA E KURRIKULAVE



Nr. 1021/4 Prot.

Tiranë, më 16/04 /2025

Lënda: Korektim në strukturën mësimore, të ndryshuar, për semestrin e dytë, në ciklin e dytë të studimeve të vitit akademik 2024-2025.

FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
FAKULTETIT TË GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË ELEKTRIKE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË MEKANIKE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT
FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE
ADMINISTRATORIT


Me shkresën tonë Nr.1021/2, datë 14.04.2025, janë përcjellë ndryshimet e bëra në strukturën mësimore vjetore për semestrin e dytë për ciklin e parë të studimeve dhe programet e integruara të ciklit të dytë dhe për ciklin e dytë të studimeve, përkatësisht me Nr.1021 Prot, datë 14.04.2025 dhe Nr.1021/1 Prot., datë 14.04.2025. Në strukturën vjetore të procesit mësimor, të ndryshuar, për programet e ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” është bërë një lapsus në datat e zëvendësimit të ditëve të pushimit. Duke ju kërkuar ndjesë për këtë lapsus, ju lutemi gjeni bashkëngjitur strukturën vjetore, të ndryshuar dhe të korektuar për procesin mësimor të programeve të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”.

Njësitë kryesore të marrin masat për të informuar stafin akademik dhe studentet.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

REKTORI

Prof. Dr. Akli Fundo





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nr. 1021/ Prot.
13

Tiranë, më 16/04/2025

NDRYSHIME NË STRUKTURËN VJETORE TË PROCESIT MESIMOR
PËR SEMESTRIN E DYTË TË VITIT AKADEMIK 2024-2025
Cikli i dytë i studimeve "Master i Shkencave" dhe "Master Profesional"

Këshilli i Ministrave ka marrë vendimin që datat 15 dhe 16 Maj 2025 të shpallen ditë pushimi për punonjësit e disa institucioneve të administratës, për shkak të Samitit të Komunitetit Politik Evropian, që do të mbahet në Tiranë. Në zbatim të këtij vendimi, në Strukturën Vjetore të Procesit Mësimor, për Semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025, bëhen ndryshimet e mëposhtëme:

Semestri i dytë:

- Pushim në datat **15.05.2025 - 16.05.2025** (e Enjte dhe e Premte) (2 ditë)
- Aktivitet mësimor nga **03.03.2025 - 27.05.2025** (12 javë)
- Dorëzime detyrash nga **28.05.2025 - 03.06.2025** (1 javë)
- Sezoni i provimeve të verës **04.06.2025 - 01.07.2025** (4 javë)
- Sezoni i mbrojtjes së diplomave **02.07.2025 - 12.07.2025** (10 ditë)
- Në datën 26.05.2025, ditën e Hënë, do të zhvillohet mësimi i ditës së Enjte
- Në datën 27.05.2025, ditën e Martë, do të zhvillohet mësimi i ditës së Premte

Sezoni i vjeshtës:

- Dorëzim detyrimesh nga **01.09.2025 - 04.09.2025**
- Sezoni i provimeve nga **08.09.2025 - 19.09.2025** (2 javë)
- Sezoni i mbrojtjes së diplomave nga **22.09.2025 - 03.10.2025** (2 javë)

Pushimet e festave gjatë periudhës së mësimdhënjes janë në datat:

22 Nëntor	Dita e Alfabetit
28-29 Nëntor 2024,	Festat e Pavarësisë dhe e Çlirimit
08 Dhjetor 2024,	Dita Kombëtare e Rinisë
14 Mars 2025,	Dita e verës
22 Mars 2025,	Dita e Novruzit
31 Mars 2025,	Festa e Fiter Bajramit
20 Prill 2025,	Festa e Pashkëve Katolike & Ortodokse
01 Maj 2025,	Dita e punëtorëve
07 Qershor 2025	Festa e Kurban Bajramit
05 Shtator 2025,	Shenjtërimi i Shenjt Terezës

Në bazë të VKM Nr.568, datë 06.10.2021, kur festa apo festat zyrtare bie/bien në ditën apo ditët e pushimit javor, atëhere pushimi shtyhet në ditën apo ditët pasardhëse të punës.

REKTORI
Prof. Dr. Akli Fundo